



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "Paper Communications" SH.P.K.

Numri Unik Identifikues: 810795809

Pronari: Ilir GRAPCI

OSHMA: Radio Classic FM

Adresa: Perandori Justinian, Sol. 1/6, Prishtinë



VENDIM

për ndryshimin e emrit të Radio Classic FM në Paper Radio dhe ndryshimin e skemes programore - me seli në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Classic FM është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (Radio), me mbulim regional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve, në gjuhën shqipe dhe me seli në komunën e Prishtinës. Radio Classic FM është pajisur me licencë të KPM-së me datën 24 dhjetor 2019, me afat të licencës prej shtatë (7) vitesh.
3. Me datën 8 dhjetor 2020, Radio Classic FM ka dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së një kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar miratim e KPM-së për ndryshimin e emrit të Radio Classic FM në Paper Radio si dhe ndryshimin e skemes programore.

Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, ndryshimi i emrit të Radio Classic FM në Paper Radio nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek qytetarët, gjatë përdorimit të tij për transmetim të programeve të radios.
5. Komisioni konstaton se, përveq ndryshimit të emrit, Radio Classic FM ka kërkuar edhe ndryshimin e skemes programore duke deklaruar se arsyeja për ndryshim të skemës është

se, skema e tanishme programore e kufizon radion në aspektin e komunikimeve komerciale, ndërsa me skemën e re programore, vlerësojnë se mundë të kenë më shumë klientë të cilët reklamojnë bizneset e tyre.

6. Duke u bazuar në arsyetimin e të licencuarit si dhe përmbajtjen e skemës së propozuar për ndryshim, Komisioni vlerëson se ndryshimi i skemës programore të Radio Classic, FM sipas dokumentit të skemës programore të propozuar dhe të bashkangjitur në kërkesë është në interes të publikut.
7. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 15 dhjetor 2020, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin emrit të Radio Classic FM në **PAPER RADIO**.
9. Komisioni, merr vendim që të miratoj kërkesën për ndryshimin e skemës programore, sipas dokumentit të skemës programore të propozuar dhe të bashkangjitur në kërkesë.
10. Përveç ndryshimit të emrit dhe skemës programore të Radio Classic FM ,nuk do të ketë në ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, dhe IV – Zonës së Mbulimit.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



15.12.2020
datë